



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 8 qershor 2011

Nr. i rastit: 2010-07

Blerim Rudi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 qershor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues i Panelit
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së përmendur më lart, paraqitur në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURA

1. Ankesa ishte regjistruar më 8 shtator 2010. Nga parashtuesi i ankesës ishte kërkuar informatë shtesë me datën 2 nëntor 2010. Kjo informatë ishte pranuar me datën 4 nëntor 2010.
2. Me 7 dhjetor 2010, Paneli ka vendosur që ta njoftoj Shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth kësaj ankese, duke ftuar atë që të dorëzoj me shkrim vërejtjet lidhur me ankesën. Gjithashtu ishte vendosur që ta shqyrtoj bazueshmërinë e kërkesës, si dhe

pranueshmërinë e saj, (Rregulla 30, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores së Punës së Panelit (më pas përmendet si RrP).

3. Vërejtjet e ShM janë pranuar me datën 20 janar 2011. Më pas ato ishin përkthyer dhe dërguar tek parashtruesi i ankesës për përgjigje nga ai.
4. Më 10 shkurt 2011, parashtruesi i ankesës ka dërguar përgjigjen e tij, e cila i ishte dërguar ShM për njoftim. ShM ka dashur që të dorëzojë sqarime shtesë. Përgjigja e tij ishte pranuar me datën 29 prill 2011, dhe i ishte dërguar parashtruesit të ankesës.
5. Më 6 maj, parashtruesi i ankesës kishte dorëzuar një letër që iu referohej vërejtjeve të tij të mëhershme lidhur me çështjen.

FAKTET

I. RRETHANAT E RASTIT

Parathënie

6. *Qendra e Inteligjencës Financiare (QIF)* ishte themeluar në përputhje me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2004/02 (shih më poshtë ligjin përkatës në fuqi). QIF është një organ i pavarur, i cili është përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe informatave për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe shkeljeve të ngjashme, dhe parandalimin e financimit të veprimtarive terroriste. EULEX-i kishte marrë përgjegjësitë në QIF në dhjetor të vitit 2008, atëherë kur ajo u bë pjesë e Departamentin Ekzekutiv të Policisë së EULEX-it. Në qershor 2010, kishte filluar procesi për bartjen e funksioneve ekzekutive të Qendrës së Inteligjencës Financiare nga EULEX-i tek Institucionet e Kosovës.
7. QIF mban bazën e të dhënave të Raporteve për Transaksionin e Parave (RTP) dhe Raporteve rreth Veprimtarive të Dyshimta (RVD), si dhe të dhënat dhe informatat e mbledhura në mënyrë që të analizohen këto raporte. Për më tepër, QIF shpërndan të dhënat dhe informatat e fshehta, që kanë të bëjnë me çështjet që janë nën kompetencën e saj, tek agjensionet e zbatimit e ligjit të Kosovës: tek Policia, Administrata Tatimore, Dogana, Banka Qendrore e Kosovës, tek organet ndërkombëtare në Kosovë: tek EULEX-i, KFOR-i, Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si dhe tek njësitë e tjera Inteligjente jashtë vendit.
8. *Komisioni Disiplinor i QIF* ishte themeluar në përputhje me Urdhëresën Administrative 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36. Sipas Vendimit Administrativ 2003/02 për zbatimin e Rregullores nr. 2001/36, një vendim i Komisionit Disiplinor mund të kundërshtohet në një Komision të brendshëm për Ankesa. Sidoqoftë, një komision i tillë nuk ishte themeluar asnjëherë brenda QIF.

9. *Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës (KPM)* ishte themeluar në shtator 2004, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 (shih më poshtë ligjin përkatës në fuqi). Ky është një organ gjysmë gjyqësor, i ngarkuar për dëgjimin dhe gjykimin e ankesave të bërë nga shërbyesit civil, lidhur me vendimet që kanë të bëjnë me emërimet dhe largimet nga puna, si dhe praktikat e punësimit brenda shërbimit civil.

Punësimi dhe shpërndarja e detyrave

10. Parashtruesi i ankesës ishte emëruar si Zëvendës Drejtor i QIF më 1 shtator 2008 përmes një konkursi të hapur. Ai ka punuar në atë pozitë nga 1 shtatori 2008 deri më 28 janar 2010, atëherë kur kontrata e tij u ishte shkëputur (shih paragrafin 22 më poshtë).
11. Sipas parashtruesit të ankuesit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij i ishin caktuar dy personave të cilët fillimisht ishin marrë në punë si analistë të inteligjencës. Në janar 2009, ata ishin caktuar si Zëvendës Drejtorë për Analiza dhe Pajtueshmëri në QIF.

Shkëputja e kontratës së punës

12. Sipas dokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i ankesës kishte dhënë intervista dhe deklarata për së paku dy gazetarë, ku më pastaj ishin botuar në gazetën ditore *Koha Ditore* më 5 dhe 30 prill, 29 tetor, 15, 16 dhe 18 dhjetor 2009. Intervista e fundit kishte të bënte me procedurën disiplinore të iniciuar ndaj parashtruesit të ankesës (shih paragrafin 15 më poshtë).
13. Në data të panjohura, parashtruesi i ankesës ishte njoftuar me gojë nga mbikëqyrësi i vet (Drejtori i QIF) se biseda me gazetarët përbënte shkelje të detyrave të tij, pasi mbikëqyrësi i tij ka pohuar se ai në mënyrë të gabuar kishte zbuluar informata të fshehta.
14. Më 25 shtator dhe 4 dhjetor 2009, parashtruesi i ankesës ka njoftuar përmes postës elektronike Shefin e Komponentit të Policisë Ekzekutive të EULEX-it, mbikëqyrësin e Drejtorit të QIF, një nëpunës të EULEX-it, rreth vështirësive që ai i kishte hasur me menaxhmentin e QIF dhe rreth presionit që ushtrohej në të nga Drejtori i QIF. Ai nuk mori asnjë përgjigje.
15. Më 7 dhjetor 2009, Drejtori i QIF kishte nisur një procedurë disiplinore ndaj parashtruesit të ankesës. Parashtruesi i ankesës ishte njoftuar me shkrim. Parashtruesi i ankesës, në të njëjtën kohë, ishte njoftuar shkurt rreth shkeljeve të dyshuara dhe ai ishte ftuar të paraqitej në një seancë dëgjimore para Komisionit Disiplinor të caktuar për datën 14 dhjetor 2009. Ai gjithashtu ishte ftuar që të paraqes ndonjë dëshmi të dokumentuar, pesë (5) ditë para mbajtjes së seancës.
16. Më 9 dhjetor 2009, nga zyra e tij parashtruesit të ankesës i ishin hequr dosjet në të cilat kishte qenë duke punuar.

17. Më 14 dhjetor 2009 ishte mbajtur një seancë e procedurës disiplinore. Parashtruesi i ankesës pretendon se ai ishte njoftuar për mbajtjen e seancës katër (4) ditë më herët, në vend të pesë ditëve më herët siç saktësohet në Urdhrin Administrativ të UNMIK-ut për Shërbimin Civil të Kosovës. Komisioni Disiplinor përbëhej nga pesë anëtarë, ndërkombëtarë dhe vendorë. Parashtruesi i ankesës kishte shkuar në seancë, mirëpo nuk kishte pranuar të marrte pjesë në të, pasi nuk pajtohej me procedurën dhe përbërjen e Komisionit Disiplinor.
18. Në të njëjtën ditë, ai ishte njoftuar me shkrim se ishte suspenduar me pagesë deri në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me rastin e tij.
19. Më 17 dhjetor 2009, parashtruesi i ankesës ishte njoftuar se për shkak të zhvillimeve të fundit, një seancë e re do të mbahej lidhur me rastin e tij, dhe se ai zyrtarisht do të njoftohej me kohë rreth kohës dhe vendit të mbajtjes së seancës.
20. Më 12 janar 2010, parashtruesi i ankesës ishte njoftuar rreth shkeljeve të dyshuara të tjera me të cilat ishte ngarkuar pas seancës së parë, dhe ishte njoftuar rreth kohës dhe vendit të mbajtjes së seancës së dytë.
21. Seanca e dytë dëgjimore ishte mbajtur më 20 janar 2010. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i ankesës kishte dërguar kërkesat e veta tek Kryetari i Këshillit Disiplinor të QIF. Ai kishte përsëritur ankesën e tij të mëhershme rreth faktit se ka qenë Drejtori i QIF e jo menaxheri i personelit ai i cili kishte iniciuar rastin. Gjithashtu, ai është ankuar se nuk ishte zhvilluar ndonjë hetim nga menaxheri i personelit, siç kërkohet sipas Nenit 31.2 të Urdhresës Administrative Nr. 2003/2, para se të mbaheshin seancat e Komisionit Disiplinor. Për më tepër, ai pretendonte se përbërja e Komisionit ishte në kundërshtim me Nenin 32.1 të së njëjtës Urdhresë.
22. Më 27 janar 2010, Komisioni Disiplinor i QIF mori vendim. U vendos se kontrata e punës së parashtruesit të ankesës të shkëputej më 28 janar 2010, për shkak të shkeljeve të shumta të Kodit të Sjelljes për Shërbyesit Civil që i kishte kryer parashtruesi i ankesës. Parashtruesi i ankesës ishte udhëzuar se afati për dorëzimin e ankesës tek KPM ndaj këtij vendimi ishte brenda 30 ditëve.
23. Më 19 shkurt 2010, parashtruesi i ankesës kishte dorëzuar një ankesë tek KPM. Më 27 prill 2010, KPM ia rikthej rastin Këshillit të Ankesave brenda QIF, që sipas ligjit është instancë e parë për ankesa. Ankesa duhej të procedohej brenda tridhjetë (30) ditëve. Në atë kohë nuk ekzistonte një Këshill i tillë i Ankesave brenda QIF. Në vendimin e datës 27 prill 2010, KPM kishte urdhëruar QIF që të merrej me atë të metë.

24. Pasi që nuk pati zhvillime të tjera lidhur me rishikimin e rastit brenda QIF, më 3 qershor 2010 parashtruesi i ankesës dorëzoi një kërkesë tek KPM për ta rishikuar vendimin e datës 27 janar 2010.
25. Në vendimin e datës 10 gusht 2010, KPM kishte shfuqizuar shkëputjen e kontratës së punës së parashtruesit të ankesës, dhe kishte urdhëruar QIF që ta rikthente atë në vendin e tij të punës brenda 15 ditëve pas dorëzimit të atij vendimi tek QIF. Për më tej kishte urdhëruar që QIF t'i paguaj parashtruesit të ankesës pagën e tij nga data e shkëputjes së kontratës së tij të punës (28 shkurt 2010) deri atëherë kur ai ishte rikthyer në vendin e tij të punës. Për më tepër, KPM ka kërkuar që të njoftohej për rikthimin e tij në vendin e punës. Për më tej, kishte njoftuar QIF se mos zbatimi i këtij vendimi do të rezultonte me njoftimin e kësaj çështje tek Kuvendi i Kosovës dhe tek Kryeministri i Kosovës.
26. QIF iu kishte dorëzuar vendimi më 12 gusht 2010. Zyrtarja ligjore e QIF me gjasë nuk kishte pranuar ta merrte atë, përderisa Drejtori i QIF ishte në pushime. Më në fund, Drejtori e kishte pranuar vendimin më 16 gusht 2010. Pastaj, parashtruesit të ankesës nuk i ishte lejuar qasja në vendin e tij të punës brenda afatit prej 15 ditëve të saktësuar në atë vendim.
27. Më 30 gusht 2010, parashtruesit të ankesës i ishte ndaluar qasja në vendin e tij të punës nga Drejtori i QIF, me gjasë ashtu siç ishte udhëzuar nga këshilltari ligjor i EULEX-it. Që prej atëherë, ai nuk është lejuar të rifilloj punën.

Procedura penale

28. Më 17 dhjetor 2009, EULEX-i - Njësia për Hetim të Krimit të Organizuar ka raportuar tek autoritete ndjekëse rreth një dyshimi ndaj parashtruesit të ankesës. Ai ishte i dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes penale të zbulimit të paautorizuar të informatave, fyerje dhe shpifje, të dënueshme sipas Nenin 169, paragrafi 1, 187 dhe 188 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
29. Më 29 qershor 2010, Prokurori Publik Komunal në Prishtinë ka vendosur që të ndërpres hetimet kundër parashtruesit të ankesës lidhur me zbulimin e paautorizuar të informatave, pasi u konstatua se nuk kishte ndonjë çështje që duhej të trajtohej. Prokurori ka udhëzuar paditësin që të inicioj një padi private ndaj parashtruesit të ankesës për fyerje dhe shpifje, nëse e zgjedh atë mënyrë.

Rishikimi i vendimit përfundimtar administrativ nga Gjykata Komunale

30. Vendimi i datës 10 gusht 2010 nga KPM që urdhëron rikthimin e parashtruesit të ankesës në vendin e tij të punës është vendim përfundimtar administrativ, që i nënshtrohet rishikimit gjyqësor në përputhje me ligjin.
31. QIF ka paraqitur një kërkesë tek Gjykata Komunale e Prishtinës për të shfuqizuar vendimin e datës 10 gusht 2010 të marrë nga KPM, dhe ta

mbajë në fuqi vendimin e QIF të marrë me datën 27 janar 2010 që t'i shkëputej kontrata e punës së parashtruesit të ankesës.

32. Këto procedura janë ende të pazgjidhura.

II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

33. Nenet 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje si: Veprimi i Përbashkët), vijon si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;

(b) të sigurojë që ruajtja dhe promovimi i zbatimit të ligjit, rregullit publik dhe sigurisë, duke përfshirë sipas nevojës në konsultim me autoritetet përkatëse ndërkombëtare civile në Kosovë, përmes kthimit apo shfuqizimit të vendimeve operacionale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës;

(d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;

(e) kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar;

(h) të merr përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur apo në mbështetje të autoriteteve kompetente të Kosovës, të siguroj ruajtjen dhe promovimin e zbatimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjensionet përkatëse të Këshillit; dhe

(i) të siguron që të gjitha veprimtaritë zbatojnë standardet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/02 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave përkatëse Penale

34. Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/02 rreth autoritetit të Qendrës Financiare të Informimit, për pjesën e vet përkatëse, vijon si më poshtë:

Qendra Financiare e Informimit ("Qendra") është themeluar brenda Shtyllës së Policisë dhe Gjyqësisë. Ajo do të merr fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Shef i Qendrës do të caktohet nga Përfaqësuesi i Veçantë i Sekretarit të Përgjithshëm pas rekomandimit nga Zëvendësi i Përfaqësuesit të Veçantë të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Gjyqësi. Qendra do të dorëzoj raportet çdo tre muaj tek Zëvendës Përfaqësuesi i Veçantë i Sekretarit të Përgjithshëm. Përbërja dhe struktura e Qendrës do të përcaktohet në një Udhëzimin Administrativ.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 rreth Shërbimit Civil të Kosovës

35. Pjesët përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36, siç janë ndryshuar nga Rregullorja Nr. 2006/20 dhe 2008/12, rreth Shërbimit Civil të Kosovës, vijojnë si më poshtë:

Neni 1 Definicioni

(a) "Shërbyes civil" do të thotë çdo punëmarrës i autoritetit punëdhënës, paga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përveç:

...

Neni 6 Kodi i sjelljes

Shërbyesit civil obligohen nga Kodi i sjelljes së Shërbimit Civil, të bashkangjitur si një shtojcë në rregulloren e tanishme, apo një Kod tjetër i sjelljes së Shërbimit Civil që pastaj mund të miratohet përmes një Vendimi të Qeverisë.

Neni 10 Funkcionet e Komisionit (të Pavarur Mbikëqyrës)

10.1 Komisioni do të:

(a) Shqyrton dhe merr vendim për ankesat kundër vendimeve të organit të punësimit në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje;

(b) Përcakton, në përputhje me nenin 12 të kësaj Rregulloreje, nëse emërimet e nëpunësve civilë në nivel të udhëheqësve të departamentit janë bërë në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje;

...

Neni 11 Ankesat

11.1 Nëpunësi civil i cili është dëmtuar nga një vendim i organit të punësimit në kundërshtim me parimet e përcaktuara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje mund të ankohet kundër vendimit të tillë tek Komisioni, në përputhje me dispozitat e këtij neni. Çdo ankesë e tillë do të shqyrtohet nga një trup prej tre (3) anëtarëve të Komisionit, të cilët do të veprojnë për Komisionin në lidhje me ankesën që u është caktuar.

11.3 Kur Komisioni bindet se vendimi i ankimuar ka shkelur parimet e përcaktuara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, ai do të urdhëroj mjete të përshtatshme korrigjuese përmes një vendimi me shkrim dhe ky vendim i drejtohet Sekretarit të Përhershëm apo zyrtarit më i lartë ekzekutiv të organit përkatës të punësimit, të cilët do të jenë përgjegjës për të ndikuar në zbatimin e urdhrin nga organi i punësimit.

11.4 Kur organi përkatës i punësimit nuk i përmbahet vendimit dhe rendit të Komisionit, Komisioni e raporton çështjen në Kuvend, e që raportin e Komisionit do ta përcjell tek Kryeministri i Kosovës.

...

11.6 Vendimi i Komisionit është vendim përfundimtar administrativ, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi.

Udhëzimi Administrativ 2003/02 për zbatimin e Rregullores Nr. 2001/36

36. Neni 33 i Urdhëresës Administrative 2003/02 obligon organin punëdhënës të themelojë një Komision të Ankesave:

Neni 33 Komisioni i Ankesave

33.1 Çdo organ i punësimit duhet të themelojë një Komision të Ankesave për të shqyrtuar ankesat e nëpunësve civil kundër ndonjë vendimi të Komisionit Disiplinor dhe ankesave kundër drejtorisë:

(a) Vendimet disiplinore lidhur me shërbyesit civilë;

...

(g) Shkëputja e marrëdhënies së punës së shërbyesit civil;

(h) Diskriminim apo ngacmim; dhe

(i) Ankesat e tjera lidhur me praktikën e drejtorisë, ose veprimet e brendshme të organit të punësimit që i janë bërë me dije komisionit të ankesave nga nëpunësi civil.

33.2 Komisioni i ankesave duhet të jetë shumetnik, i balancuar në aspektin gjinor dhe i përbërë nga dy (2) anëtarë të përhershëm dhe një anëtar i tretë i cili emërohet nga organi i punësimit veçmas për çdo rast. Anëtarët duhet të jenë nëpunës të lartë civilë të organit të punësimit. Një (1) nga dy (2) anëtarët e përhershëm duhet të caktohet për të kryesuar komisionin. Dispozitat e nenit 7.3 të kësaj urdhërese duhet të respektohen, *me ndryshimet e nevojshme (mutus mutandis)*, në përputhje me të gjitha rastet kur kërkohet të bëhet përjashtim nga parimi i shumëllojshmërisë.

33.3 Anëtari i Komisionit të Ankesave nuk mund të jetë anëtar i Komisionit Disiplinor i organit të punësimit.

33.4 Çdo anëtar i Komisionit të Ankesave i cili mund të ketë konflikt të interesit në një rast të veçantë, duhet të tërhiqet dhe se organi i punësimit duhet të caktojë një anëtar tjetër për atë rast të veçantë.

33.5 Komisioni i Ankesave kryen funksionet e mëposhtme:

(a) Në rast të ankesave kundër vendimeve të Komisionit disiplinor:

(i) Duhet të vendosë nëse ka arsye legjitime për të pranuar një ankesë kundër vendimi të komisionit disiplinor;

(ii) Nëse ankesa është pranuar, të vendosë se a është apo nuk është e arsyeshme pasi t'i ketë shqyrtuar provat dhe t'i ketë dëgjuar palët në fjalë; dhe

(iii) Në rast se ankesa mbahet si arsyetim për dhënien e urdhrave për ofrimin e ndihmës adekuate juridike ankuesit; dhe

(b) Në rastin e llojeve të tjera të ankesave të përmendura në nenin 33.1:

(i) Të ofron mundësi për zbulimin e provave dhe dëgjimin e palëve;

(ii) Të vendosë nëse ankesa është e arsyeshme apo jo, dhe

(iii) Në rast se ankesa mbahet për t'u arsyetuar, të vendos lidhur me mjetet korrigjuese që duhet të ofrohen, dhe nga kush duhet të ofrohen.

33.6 Komisioni i ankesave duhet që për sa është e mundur ta përfundojë dëgjimin e rastit brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të tij.

...

Ligji Nr. 3/L-192 për Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

37. Ligji Nr. 3-L-192 është miratuar më 15 korrik 2010. Ky Nen thotë:

“Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon e zbatimin e vendimit të Këshillit”.

38. Neni 23 i këtij Ligji thotë:

“Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12, për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë.

Ky Ligj hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

39. Ligji ka hyrë në fuqi më 30 gusht 2010.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

40. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës (e drejta për gjykim të rregullt).

41. Për më tepër, në thelb ai ankohet sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (e drejta për zotërimin paqësor të pronës) se ai as nuk është rikthyer në vendin e tij të punës pas vendimit përfundimtar të marrë nga KPM e as nuk është kompensuar në përputhje me vendimin për dëmin financiar që ai ka pësuar, si pasojë e shkarkimit të tij nga puna.

42. Dispozitat përkatëse të Konventës vijojnë si më poshtë:

Neni 6 E drejta për proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit, e cila do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...

Neni 1 (Protokollit Nr. 1) Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara sipas ligjit dhe sipas parimet të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligjet, që ato i cilësojnë të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve, ose të gjobave të tjera”.

...

PRANUESHMËRIA

43. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do t'i pranojë ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të RrP.

44. Ankesa i është paraqitur Panelit më 8 shtator 2010, pra brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranojë ankesa (8 qershor 2010).

45. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv ka të bëjë me disa çështje që lidhen me policinë, drejtësinë dhe doganat.
46. Paneli vë në dukje se Shefi i Misionit pranon përfshirjen e EULEX-it në rastin në fjalë. Prandaj Paneli e cilëson si të përshtatshme që të pranohet se rasti bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it.

Bazueshmëria

Dokumentet e dorëzuara nga palët

Komentet nga ShM të EULEX-it në Kosovë

47. Shefi i Misionit nuk ka kontestuar faktet e paraqitura nga parashtruesi i ankesës dhe faktet që janë përmbledhura nga Paneli në bazë të dokumenteve në dispozicion.
48. Ai parashtroj se QIF ishte bartur tek EULEX-i në dhjetor 2008. Sipas Marrëveshjes Teknike rreth bartjes së QIF në Njësinë e Inteligjencës Financiare (NjIF), dhe sipas Ligjit të Kosovës për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit, EULEX-i do ta bart autoritetin e QIF tek NjIF, përderisa do t'i mbaj disa funksione ekzekutive në përputhje me Mandatin e vet.
49. Në përgjigjet e veta ShM ka pranuar se Neni 6 § 1 i Konventës ishte i zbatueshëm për rrethanat e kësaj ankese.
50. Ai më tej vuri në dukje se vendimi përfundimtar i datës 10 gushtit 2010 i marrë nga KPM ishte një vendim administrativ përfundimtar. Ai i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi. Një shqyrtim i tillë ishte iniciuar nga QIF dhe çështja ishte në pritje pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës.
51. Në kërkesën e tyre për shqyrtim, QIF kishte paraqitur se KPM ka shkelur rregullat procedurale dhe ka zbatuar ligjin në mënyrë të gabuar. Për më tej, ishte argumentuar se KPM nuk arriti që në mënyrë të rregullt t'i vërtetojë faktet e rastit të parashtruesit të ankesës. QIF kishte kërkuar që vendimi i marrë nga KPM duhet të shpallet i pavlefshëm dhe se vendimi për ta shkëputur kontratën e parashtruesit të ankesës duhet të mbështetet.
52. ShM e pranon se procedurat gjyqësore nuk e pengojnë zbatimin e vendimit përfundimtar të KPM, duke urdhëruar rikthimin e parashtruesit të ankesës në vendin e tij të punës.
53. Megjithatë, në dokumentet e tij shtesë të parashtruara me datën 26 prill 2011, ShM ka argumentuar se Ligji Nr. 03/L-192 rreth Këshillit të

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimit Civil të Kosovës i cili ka zëvendësuar Rregulloret e UNMIK-ut që rregullojnë çështjet e rëndësishme nuk është i zbatueshëm për rastin e parashtruesit të ankesës. Vendimi i KPM, siç përmendet në vetë vendimin, është bërë në përputhje me Rregulloret e UNMIK-ut, ndërsa Ligji në fjalë ka hyrë në fuqi me datën 31 gusht 2010.

54. Më tutje është argumentuar se QIF e ka cilësuar se rikthimi i parashtruesit të ankesës do të jetë në kundërshtim me interesin publik, në dëm të buxhetit të Kosovës dhe mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave të ndjeshme të mbledhura nga QIF. Mbi këto baza QIF kishte vendosur që mos ta rikthej parashtruesin e ankesës në pozitën e tij, mirëpo që përkohësisht ta pezulloj zbatimin e vendimit të KPM-së, me qëllim të mbrojtjes së dokumenteve dhe informatave konfidenciale. QIF kishte konsideruar se rikthimi i tij nuk ishte i detyrueshëm në këtë fazë dhe vendosi për të pritur rezultatin e procedurave gjyqësore.
55. ShM ia kishte lënë Panelit që të përcaktoj nëse arsyet e paraqitura nga QIF ishin të mjaftueshme për ta arsyetuar vendimin e saj që mos të zbatohet vendimi i marrë nga KPM.
56. ShM pranoi se ky vendim nuk ishte zbatua. Megjithatë, ai konsideroj se refuzimi për ta bërë këtë nuk përbënte shkelje të Nenit 6 të Konventës, pasi vendimi ishte duke u shqyrtuar nga gjykata.
57. Sa i përket ankesës sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, ShM vuri në dukje se një "kërkesa" mund të cilësohet si "posedim" sipas Nenit në fjalë, në qoftë se do vërtetohej mjaftueshëm për t'u zbatuar. Ai iu referua vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastin *Burdov kundër Ruisë*, nr. 59498/00, KEDNj 2002 III.
58. Megjithatë, ShM ka konsideruar se Neni 1 i Protokollit 1 nuk ishte shkelur në rastin në fjalë, sepse vendimi përfundimtar administrativ ishte nën shqyrtim gjyqësor dhe zbatimi i tij do të ishte në kundërshtim me interesin publik, buxhetin e Kosovës dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave të QIF.

Komentet nga parashtruesi i ankesës

59. Parashtruesi i ankesës pohon se fakti që ai nuk ishte rikthyer në pozitën e tij, dhe as nuk iu kishte paguar paga e tij, përkundërt vendimit përfundimtar administrativ, do të thoshte se iu kishin shkelur të drejtat e tij.
60. Ai gjithashtu pohoi se EULEX-i ka shkelur legjislacionin duke mos zbatuar vendimin përfundimtar administrativ dhe duke bërë akuza të paarsyetuara ndaj tij, pa ofruar prova. Ai iu referua Nenit 14 të Ligjit Nr. 3/L-192 (shih paragrafin 37 më lart), sipas të cilës iniciimi i një kontesti administrativ nuk duhet të pezulloj zbatimin e vendimit të KPM.

Vlerësimi i Panelit

Parimet e përgjithshme në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës

61. Një person mund të pretendojnë se ka shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm në masën sa vendimet e kundërshtuara i referohen "pronësisë" të tij brenda kuptimit të kësaj dispozite. "Pronësitë" mund të jenë edhe "pronësi ekzistuese" ose asete, duke përfshirë kërkesat, në lidhje me të cilat aplikanti mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një "pritshmëri të ligjshme" për të gëzuar në mënyrë efektive të drejtën në pronësi (shih KEDNj, *J.A. Pye (Oxford) Ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 44302/02, § 61, KEDNj 2007-X; *Maltzan dhe të Tjerët kundër Gjermanisë* (dec.) [GC], nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74 c, KEDNj 2005-V; *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], nr. 44912/98, § 35 c, KEDNj 2004-IX).
62. Koncepti i "pasuritë" në pjesën e parë të Nenit 1 të protokollit Nr. 1 ka një kuptim autonom e cila nuk kufizohet vetëm në pronësinë e mallrave fizike dhe është e pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendor: të drejta dhe interesa të tjera të caktuara që cilësohen si asete mund të konsiderohen si "të drejta pronësore", dhe në këtë mënyrë si "pronësi" sa i përket kësaj dispozite. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast është nëse rrethanat e rastit, të konsideruara si një e tërë, janë të dhëna në titullin e aplikantit për interesa thelbësore të mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, KEDNj, *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], nr. 48939/99, § 124, KEDNj 2004-XII; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], nr. 73049/01, § 63, KEDNj 2007-I; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], nr. 31443/96, § 129, KEDNj 2004-V; *Beyeler kundër Italisë* [GC], nr. 33202/96, § 100. KEDNj 2000-I).
63. Mund të thuhet se nuk mund të ngitet asnjë pritshmëri legjitime kur ekziston një kontest lidhur me interpretimin e saktë dhe zbatimin e ligjit vendor dhe kur dokumentet e paraqitura nga aplikanti janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat vendore (*Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë, cituar më lart*, § 65; *Kopecky kundër Sllovakisë, cituar më lart*, § 50).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rastin në fjalë

64. Në masën sa aplikanti është mbështetur në kuptimin e Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës dhe në masën sa ajo mund të kuptohet se ai ka menduar që vendimi i KPM ka krijuar për të asete apo pritshmëri të ligjshme për ta gëzuar pronësinë e tij brenda kuptimit të kësaj Dispozite, Paneli ka konsideruar si më poshtë:
65. Paneli vë në dukje se, së pari, në rastin konkret duhet të nxirret një dallim në mes të kërkesës së parashtruesit të ankesës për ta shpallur të paligjshëm dhe të pavlefshëm shkëputjen e kontratës së tij përmes vendimit të datës 28 janar 2010, dhe çështjes që ngitet në lidhje me mos zbatimin e vendimit të KPM të datës 10 gusht 2010.

66. Në lidhje me vendimin e datës 28 janar 2010, Paneli vë në dukje se QIF ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të kërkuar një shqyrtim gjyqësor të atij vendimi dhe gjithashtu vë në dukje se kjo çështje është në pritje pranë gjykatës kompetente. Përderisa kërkesa e parashtruesit të ankesës në lidhje me vendimin e datës 28 janar 2010 është ende subjekt i rishikimit gjyqësor, rezultati i cili mbetet për tu parë, tashti do të ishte e parakohshme që Paneli t'iu qasej këtij elementi të kësaj ankese. Prandaj, Paneli nuk mund ta pranoj se në këtë aspekt parashtruesi ankesës aktualisht ka një kërkesë e cila bie brenda nocionit të "pritshmërisë të ligjshme", e mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të kësaj Konvente.
67. Megjithatë, në lidhje me mos zbatimin e vendimit të KPM të datës 10 gusht 2010, Paneli vëren se ky vendim administrativ ishte vendim përfundimtar.
68. Nga dokumentet e parë të dorëzuara, ShM pranon se inicimi i një shqyrtimi gjyqësor nuk e ka pengua zbatimin e atij vendimi. Prandaj, Paneli konstaton se vendimi i KPM i datës 10 gusht 2010 ka prodhuar tek parashtruesi i ankesës një pritshmëri të ligjshme se ai vendim do të zbatohet para përcaktimit përfundimtar të ligjshmërisë së shkëputjes së kontratës së punës së parashtruesit të ankesës, e cila do të përcaktohet nga shqyrtimi gjyqësor në kohë të duhur.
69. Për aq sa ShM ka argumentuar në dokumentet e dorëzuara më vonë, se nuk ishte e detyrueshme që të zbatohet vendimi i datës 10 gusht 2010, Paneli do të trajtojë këtë çështje nga pikëpamja e ligjshmërisë së mos zbatimit të saj.
70. Paneli konstaton se në rrethanat e rastit cilësuar si një tërësi, parashtruesi i ankesës mund të konsiderohet se ka pasur, përmes vendimit të datës 10 gusht 2010, interes të konsiderueshëm, që mbrohet nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës.
71. Paneli rithekson se kërkesa e parë dhe më të rëndësishme e Nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje nga autoriteti publik në gëzimin paqësor të pasurisë duhet të jetë e ligjshme: fjalia e dytë e paragrafit të parë autorizon privimin nga pasuria vetëm "kur i nënshtrohet kushteve të parapara me ligj" dhe paragrafi i dytë pranon se Shtetet kanë të drejtë për të kontrolluar përdorimin e pronës me zbatimin e "ligjeve" (shih KEDNj, *ish-mbreti i Greqisë dhe të Tjerët kundër Greqisë* [GC], nr. 25701/94, §§ 79 dhe 82, KEDNj 2000-XII).
72. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 gjithashtu kërkon që çdo privim nga pronësia që vjen si arsye e asaj që u tha në fjalinë e dytë qoftë në interesin publik ose në ndjekjen e qëllimit legjitim përmes mënyrave duhet të jetë në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin që kërkohet të realizohet (shih KEDNj, në mesin e autoriteteve të tjera, *Jahn dhe të Tjerët kundër Gjermanisë* [GC], nr. 46720/99, 72203/01 dhe 72552/01, §§ 81-94, KEDNj 2005).

73. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 gjithashtu kërkon që çdo ndërhyrje të jetë në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin që kërkohet të realizohet (*shih Jahn dhe të tjerët kundër Gjermanisë* [GC], nr. 46720/99, 72203/01 dhe 72552/01, §§ 81-94, KEDNj 2005 VI). Si pasojë, një ndërhyrje duhet të arrijë një "ekuilibër të drejtë" në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore individuale. Balanci i drejtë i nevojshëm nuk do të jetë i prekur kur personi në fjalë mban barrë individuale dhe të tepërt (*shih Sporrang dhe Lönnroth kundër Suedisë*, 23 shtator 1982, §§ 69-74, Seria A nr. 52).
74. Për më tepër, parimi i "qeverisjes së mirë", kërkon që kur një çështje e një interesi të përgjithshëm është në rrezik, është detyrë e autoriteteve publike për të vepruar në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe me konsistencë maksimale (*shih KEDNj, Beyeler kundër Italisë*, cituar më sipër, § 120, dhe *Megadat.com S.r.l kundër Moldavisë*, nr. 21151/04, § 72, 8 prill 2008).
75. Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se Drejtori i QIF, duke vepruar sipas këshillave që vijnë nga EULEX-i, e pengoi parashtruesin e ankesës të rikthehej në punën e tij, pasi vendimi i formës së prerë nga ana e KPM kishte urdhëruar që ai të rikthehej në vendin e punës së tij. Për të njëjtën arsye, u vendos që të mos zbatohet vendimi i KPM, për aq sa aty urdhërohet që paga e papaguar e aplikantit për periudhën nga data 28 shkurt 2010 e tutje duhet t'i paguhet atij.
76. Paneli është i mendimit se refuzimi i zbatimit të vendimit të KPM përbën ndërhyrje në të drejtën e parashtruesit të ankesës në gëzimin paqësor të pronësisë së tij.
77. Duhet që pastaj të shqyrtojë nëse ky vendim ishte i ligjshëm, a i ka shërbyer interesit publik dhe nëse ajo ka prekur ekuilibrin e drejtë midis interesave të komunitetit dhe atyre të aplikantit.
78. Sa i përket ligjshmërisë së vendimit për të mos zbatuar vendimin e KPM të datës 10 gusht 2010, Paneli vëren se parashtruesit të ankesës nuk i është dhënë asnjë arsye me shkrim për të.
79. Më tutje vihet re se në dokumentet e dorëzuara, ShM nuk ka ofruar një shpjegim, që i referohet fakteve konkrete të çështjes, se pse rikthimi i parashtruesit të ankesës në përputhje me vendimin e KPM do t'i pengonte interesat e shërbimit. Gjithashtu, nuk është treguar se parashtruesi i ankesës ndonjëherë ka qenë i njoftuar rreth bazave të tilla faktike, qoftë me gojë ose me shkrim.
80. Në këtë kontekst, më tutje vihet re se asnjë argument nuk është paraqitur nga ShM për të treguar se ky refuzim ka pasur bazë ligjore, dhe asnjë dispozitë konkrete ligjore nuk është referuar.
81. Vetëm këto arsye me shkrim të këtij vendimi, që në mënyrë të qartë tregojnë bazën ligjore për të, duke iu referuar rrethanave konkrete

faktike të rastit, mund të kenë dhënë një vlerësimi objektiv (pas ngjarjes - *post-hoc*) nëse ai vendim ka qenë në përputhje me kërkesat e ligjshmërisë.

82. Duke pasur parasysh mungesën e arsyeve të vendimit të kontestuar dhe duke pasur parasysh mos paraqitjen e dispozitës ligjore që mund të interpretohej si bazë për të, Paneli konstaton se ndërhyrja e kontestuar në të drejtën e parashtruesit të ankesës në gëzimin paqësor të pasurisë së tij, në një formë të një “pritshmërie të ligjshme”, nuk mund të konsiderohet “e ligjshme” sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1.
83. Ky konstatim e bën të panevojshme që të shqyrtohet nëse ajo ndërhyrje ishte bërë në interes të publikut, apo nëse një ekuilibër i drejtë ishte goditur midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit.
84. Prandaj ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

Parimet e përgjithshme të Nenit 6 të Konventës dhe zbatimi i tyre në rastin në fjalë

85. Më tej, Paneli vëren se vendimet rreth bazueshmërisë së rastit të parashtruesit të ankesës, deri tani, janë dhënë nga Komisioni Disiplinor i themeluar në kuadër të QIF, dhe më pas nga KPM.
86. Ky vë në dukje dokumentin e dorëzuar nga parashtruesi i ankesës se nuk ishte themeluar asnjë Komision kompetent për Ankesa, për t'i dëgjuar ankesat e shërbyesve civilë rreth çështjeve disiplinore dhe çështjeve të punësimit brenda QIF, ashtu siç duhej të ishte sipas Urdhëresës Administrative 2003/02 për zbatimin e Rregullores nr. 2001/36. Paneli konsideron se kjo do të ishte e preferueshme nëse një organ i tillë të ishte i themeluar brenda QIF në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje. Megjithatë, nuk është e nevojshme për Panelin që të merr një qëndrim rreth rrethanave të rastit në fjalë, lidhur me atë se nëse dështimi nga ana e EULEX-it për të themeluar atë, si e tillë, ishte e barasvlershme me shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.
87. Paneli ripërsërit se nuk është në kundërshtim me Nenin 6 § 1 të kësaj Konvente që të jepet kompetenca për të gjykuar rreth të drejtave civile dhe detyrimeve për autoritetet administrative, me kusht që vendimet e tyre t'i nënshtrohen kontrollit të mëvonshëm nga një “gjykatë” që ka juridiksion të plotë (shih, midis shumë autoriteteve, KEDNj, *Nowicky kundër Austrisë*, nr. 34983/02, § 41, 24 shkurt 2005). Nuk është e detyrueshme qoftë edhe për organet e punësimit që punësojnë personat të cilët gëzojnë statusin e nëpunësve civil, gjatë procedurave të brendshme që lidhen me çështjet që kanë të bëjnë me punësim, karrierë dhe shkarkim nga puna, të sigurojnë garancitë procedurale të plota të kësaj dispozite, dhe përcaktimin prej instancës së parë apo të dytë të çështjeve të tilla, nga organet që punojnë në përputhje me

kërkesat që një “gjykatë” duhet të plotësoj sipas Nenit 6 § 1 të Konventës, me kusht që një apelim kundër vendimit të tyre më pastaj të jetë në dispozicion.

88. Megjithatë, çështja e paanësisë së procedurave gjyqësore që kanë kryer shqyrtimin e vendimeve administrative duhet të shqyrtohet jo në terme abstrakte, por mbi bazën e rishikimit të rasteve një-për-një atëherë kur procedurat ishin ndërprerë. Veçse është vënë re se në rastin konkret, procedurat në lidhje me shkëputjen e kontratës së punës së parashtruesit të ankesës janë ende të pazgjdhura pranë gjykatave.
89. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të ankesës rreth parregullsisë së procedurave janë të parakohshme dhe duhet të hidhen poshtë si të pabazuara sipas Rregullore 29 të Rregullores së Punës së Panelit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI, ME SHUMICË

1. *Shpall* ankesën, sa i përket Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankesave të papranueshme;
2. *Vlerëson* se ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës;
3. *Konstaton* të përshtatshme, nga pikëpamja e gjetjeve të fakteve dhe ligjit, që t'i bëjë rekomandime ShM; dhe
4. *Rekomandon* që ShM t'i ndërmerr këto veprime, të paraqitura si në vijim:
 - Duhet të jepet një deklaratë që pranon se rrethanat e këtij rasti përbëjnë shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv; dhe
 - Duhet të ndërmerret një hetim rreth masave specifike të cilat ShM mund t'i ndërmerr, në mënyrë që t'i jepet fund një shkeljeje që është konstatuar në këtë rast.

ShM ftohet që të njoftoj Panelin rreth masave që ai ka ndërmend t'i ndërmerr në lidhje me këtë vendim deri me datën 8 gusht 2011.

Për më tepër, ShM ftohet që të njoftoj Panelin dhe parashtruesin e ankesës rreth masave që janë ndërmarrë, dhe rreth rezultateve që kanë dalë nga to, deri më datën 31 nëntor 2011.

Për Panelin,

John J. RYAN
Këshilltar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit